



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:011951

Datë: 11.12.2023

Numri i dokumentit: 05040974

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.249/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari Leon Përlaska, me procesmbajtëse Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të pandehurve H. K. dhe R. K. nga Peja, sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.2174/17 të datës 14.04.2018 për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 06.12.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit H. K. me mbrojtësin e tij Av.Idriz Ibraj dhe të pandehurit R. K., në të njëjtën ditë e shpalli ndërsa me datë 11.12.2023 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurve:

I. H. K. i lindur në fshatin N. Komuna e Pejës, ku edhe banon, pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të numrit personal, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, dhe

II. R. K. i lindur me në fshatin N. Komuna e Pejës, ku edhe banon pensioner i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të numrit personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së:

REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

Qe nga viti 2015 e tutje, në Rugovë, ZK L., në mënyrë të kundërligjshme kanë uzurpuar pronën e paluajtshme të të dëmtuarit M. D., në atë mënyrë që të pandehurit që nga viti i lartcekur e gjer me sot shfrytëzojnë parcelën ZK-L., me sipërfaqe 43409 m², e cila është e evidentuar në emër të të dëmtuarit të lartcekur, dhe të njëjtën patundshmëri të pandehurit nuk e lirojnë edhe përkundër faktit se i dëmtuari e kërkon një gjë të tillë,

- me çka kishin për të kryer veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur më nenin 31 të KPRK-së.

II. Shpenzimet e procedurës mbeten në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Pejë me datë 14.04.2018 ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.2174/2017 kundër të pandehurve H. K. dhe R. K. për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 lidhur më nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datat 06.12.2023, në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku të pandehurit H. K. me mbrojtësin e tij Av.Idriz Ibraj dhe të pandehurit R. K..

Në këtë seancë u administruan provat materiale dhe personale të propozuara nga palët, ku në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit u tërhoq nga akuza me arsyetimin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet se të pandehurit e kanë kryer veprën penale që u ngarkohet.

Si rrjedhojë gjykata mbeti pa objekt shqyrtimi, përkatësisht në këtë rast vjen në shprehje karakteri akuzator i procedurës penale, parimi “nemo iudex sine actore”, që nënkupton se tërheqja e aktakuzës e eliminon bazën juridike për vazhdimin e gjykimit, si rrjedhojë në frymën e këtij

parimi dhe në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1. të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata u bazua në nenin 453 par.1 të KPPRK-së. ku thuhet “Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”.

Duke u bazuar në faktet e parashtruara dhe në baze të nenit 362 par.1 pika 1.1 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
P.nr.249/18, dt.11.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.